



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Nr. 1625/Prot.
11

Tiranë, më 25.2.2020

NJOFTIM PËR VENDE PUNE

A. Lëvizja paralele

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Kreu V – "Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë", nenit 25, "Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.3.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës, dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", i ndryshuar Kreu VII dhe planit vjetor të pranimit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, njofton se;

- a) Në Administratën e tij ka 1 (një) vend të lirë pune, të kategorisë ekzekutive në grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm në pozicionin;
- Specialist në Sektorin e Administrimit të IT

Paga e pozicionit- III-b;

Në përputhje me Vendimin nr. 48, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 55/2014 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave", të ndryshuar".

Punonjësi duhet të ofrojë një shërbim sipas standardeve të cilësisë dhe të kohës.

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

b) Përshkrimi i detajuar i vendit të punës;

Puna e Specialistit të IT konsiston në suportin teknik të përdoruesve, si dhe zgjidhjen e problemeve. Suporti kryhet në software, hardware dhe mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike. Specialisti është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të skanimit të deklaratave të interesave private dhe realizimin brenda afateve të përcaktuara. Instalon, konfiguron, mirëmban serverat (Web Server, E-mail Server, Proxy Server, Antivirus). Planifikon dhe implementon teknologji software dhe sisteme, mbikqyr zhvillimet për të



ILDKPKI

Rr. "Reshit Çollaku", Tiranë, Shqipëri. Tel. + 355 42 259 461, www.ildkpkj.al, info@hidaa.gov.al

përmbushur kërkesat teknike dhe ato të punonjësve të insitucionit. Specialisti IT është personi përgjegjës për të udhëzuar dhe trajnuar punonjësit e rinj për programet informatike: E-mail, Adope Acrobat Professional, Symantec Endpoint Protection, si dhe ç' do program tjetër nëse është i nevojshëm të përdoret.

c) Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon,
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi,
- Të ketë të paktën një vlerësim e fundit “Mirë” apo “ Shumë mirë”,

ç) Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon;

- Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo të barasvlefshme me diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND), në degët “Inxhinieri elektronike”, “Informatikë” apo “Shkenca Kompjuterike, sipas legjisllacionit të arsimit të lartë
- të ketë përvojë mbi 1 vit në drejtim të fushës përkatëse të studimit;
- Të ketë njohur të mira në Windows Server 2012/2016;
- Të ketë njohuri të mira në meanxhimin e Active Direcotory;
- Të ketë njohuri mbi databazat (SQLserver, My SQL)
- Të ketë njohuri shumë të mira mbi produktet e Microsoft si paketa Office 2013/2016
- të ketë njohuri në një gjuhë të huaj;
- nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike;
- aftësi të mira komunikuese, organizative dhe punës në grup;

d) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Sektorin e Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurive, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- Jetëshkrimi i plotësuar;
- Fotokopje e diplomës. (*përfshirë dhe diplomën bachelor*) Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave;
- Fotokopje e librezës së punës (*të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën*);
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Fokopje e kartës së identitetit.

dh) Pranimi i dokumentave do të bëhet deri në datën 10.3.2020.

e) Në datën 12.3.2020 , do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin (në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen



zyrtare të ILDKPKI dhe në stendën e informimit të publikut). Këta do të jenë ata që plotësojnë kushtet minimale të lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, të kërkuara më sipër.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse e ILDKPKI, nëpërmjet adresës së e-mail.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në njësinë përgjegjëse, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

ë) Konkurrimi - intervista me gojë do të bëhet në datën **24.3.2020**, në mjediset e ILDKPKI, në orën **10:00**.

f) Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurrimi

Konkurrimi për kandidatët, do të bazohet në njohuritë për;

- Kushtetutën,
- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”,
- Ligji nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”
- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 10 325, datë 23.09.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”
- Kodi i Procedurave Administrative,
- Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, “Rregullat e etikës në administratën publike”,
- Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, Normat teknike profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ndryshuar
- Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar si dhe pyetje të tjera nga specialiteti.

g) Kandidatët do të vlerësohen nga “Komisioni i Brendshëm”, i ngritur pranë ILDKPKI. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht: 40 pikë për dokumentacionin dhe 60 pikë për intervistën e strukturuar me gojë. Dokumentacioni i dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet në fushën përkatëse dhe 10 pikë për çertifikimin pozitiv.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me;

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

gj) **Lista e fituesve do të jetë me të paktën 70 pikë (70% të pikëve).** Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, ILDKPKI do të njoftojë ata individualisht, në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës e-mail*). Lista e fituesve do të shpallet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të ILDKPKI dhe në stendën e informimit të publikut.

Për sqarime, mund të kontaktoni në adresën: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Rruga “Reshit Çollaku”, Tiranë, si dhe në faqen zyrtare në internet www.ildkpkj.al.

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil.

Nëse nuk ka fitues, nga procedura e lëvizjes paralele, konkurrimi do të vazhdojë sipas Kreut IV – “Pranimi në shërbimin civil”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës, dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar.

Kreu II, “Pranimi në shërbimin civil

B. Pranimi në shërbimin civil

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, procedura do të vazhdojë me plotësimin e vendeve të lira pune, të kategorisë ekzekutive në grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm në pozicionin Specialist në Sektorin e Administrimit të IT.

Këtë Informacion do ta merrni në faqen zyrtare të ILDKPKI, www.ildkpkj.al, si dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në stendën e informimit të publikut.

Edhe për këtë procedurë aplikohet në të njëjtën kohë

a) Pëshkrimi i detajuar i vendit të punës;

Puna e Specialistit të IT konsiston në suportin teknik të përdoruesve, si dhe zgjidhjen e problemeve. Suporti kryhet në software, hardware dhe mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike. Specialisti është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të skanimit të deklaratave të interesave private dhe realizimin brenda afateve të përcaktuara. Instalon, konfiguron, mirëmban serverat (Web Server, E-mail Server, Proxy Server, Antivirus). Planifikon dhe implementon teknologji software dhe sisteme, mbikqyr zhvillimet për të përmbushur kërkesat teknike dhe ato të punonjësve të insitucionit. Specialisti IT është personi përgjegjës për të udhëzuar dhe trajnuar punonjësit e rinj për programet informatike: E-mail, Adope Acrobat Professional, Symantec Endpoint Protection, si dhe ç'do program tjetër nëse është i nevojshëm të përdoret.

b) Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurrimi

Konkurrimi për kandidatiët, do të bazohet në njohuri mbi:

- Kushtetutën,

- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”,
- Ligji nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”
- Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr. 10 325, datë 23.09.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”
- Kodi i Procedurave Administrative,
- Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Rregullat e etikës në administratën publike”,
- Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, Normat teknike profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe pyetje të tjera nga specialiteti.

c) Konkurrimi

Konkurrimi do të mbështetet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe do të kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë.

Konkurrimi do të zhvillohet në dy faza;

- 1) Verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta.
- 2) Vlerësimi i kandidatëve.

ç) Kërkesat e Përgjithshme

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil në përputhje me nenin 21 të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;

d) Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon;

- Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo të barasvlefshme me diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND), në degët “Inxhinieri elektronike”, “Informatikë” apo “Shkenca Kompjuterike”, sipas legjisllacionit të arsimit të lartë

- të ketë përvojë mbi 1 vit në drejtim të fushës përkatëse të studimit;
- Të ketë njohuri të mira në Windows Server 2012/2016;
- Të ketë njohuri të mira në meanzhimin e Active Directory;
- Të ketë njohuri mbi databazat (SQLserver, My SQL)
- Te ketë njohuri shumë të mira mbi produktet e Microsoft, si paketa Office 2013/2016
- të ketë njohuri në një gjuhë të huaj;
- nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike;
- aftësi të mira komunikuese, organizative dhe punës në grup;

dh) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Sektorin e Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurive, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- Jetëshkrimi i plotësuar;
- Fotokopje e diplomës. (*përfshirë dhe diplomën bachelor*) Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njëzuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave;
- Fotokopje e librezës së punës (*të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën*);
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Fokopje e kartës së identitetit.

Mosparaqitje e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

e)Pranimi i dokumentave do të bëhet deri në datën 13.3.2020

ë) Lista e vlerësimit paraprak e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin, do të shpallet në **datë 24.3.2020**, në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, në faqen zyrtare të ILDKPKI, www.ildkpk.al, dhe në standën e informimit të publikut.

Këta do të jenë ata që plotësojnë të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të kërkuara më sipër. Ankesat nga kandidatët paraqiten në njësinë përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse e ILDKPKI, nëpërmjet adresës së e-mail.

f) Konkurrimi - testimi me shkrim do të zhvillohet me datë 7.4.2020 ora 10:00 pranë zyrave të ILDKPKI

g) Mënyra e vlerësimit

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë institucionit të ILDKPKI. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- vlerësimi i jetëshkrimit - 15 pikë,



ILDKPKI

Rr. "Reshit Çollaku", Tiranë, Shqipëri, Tel. + 355 42 259 461. www.ildkpk.al, info@hidaa.gov.al

- intervista e strukturuar me gojë - 25 pikë,
- testimi me shkrim - 60 pikë.

Pas përfundimit të vlerësimit të testit me shkrim, kur kandidati merr mbi 30 pikë e lart, ai i nënshtrohet intervistës së strukturuar me gojë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me;

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën

gj) Lista e fituesve do të jetë me kandidatë që kanë fituar me mbi 70 pikë (mbi 70% të pikëve)

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, ILDKPKI do të njoftojë ata individualisht, në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës e-mail*)

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën “*Pranimi në shërbimin civil*”, do të marrin informacion në faqen e ILDKPKI, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure.

Njoftimi do të bëhet: në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të ILDKPKI, www.ildkpkj.al dhe në stendën e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për këtë procedurë, duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e ILDKPKI.

Për sqarime, mund të kontaktoni në adresën: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Rruga “Reshit Çollaku”, Tiranë.

ILDKPKI
NJËSIA PËRGJEGJËSE